

VENDIM
Nr. 984, datë 1.2.2019

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*”, të VKM-së nr. 103, datë 4.2.2015, “*Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve*”, i ndryshuar me vendimin nr. 338, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave dhe Ankimit për vendimin përfundimtar me **nr. 14, datë 3.9.2018, të ISHMPU-së Dega Rajonale Tiranë**, ndaj subjektit “**Agrotek Farm TIK-TIK**” sh.p.k., protokolluar me nr. 5009 prot., datë 21.9.2018,

Komisioni:

Sa më sipër nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët arsyeton se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në përputhje me germën “b”/iii, të pikës 1, të nenit 29, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “*Për lejet e mjedisit*”, i ndryshuar. Pasi shqyrtoi ankesën e subjektit dhe masën administrative në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”,

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendim dënimi nr. 14 datë 3.9.2018 në vlerën 300.000 lekë dhe rrëzimin e ankimit të subjektit ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTORI
Armando LAMAJ

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.